# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-474381**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Komisioni Artistik-Kulturor miraton propozimin e Veliajt: Thaçi dhe Komandantët e UÇK-së “Qytetarë Nderi” të Tiranës |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/27/komisioni-artistik-kulturor-miraton-propozimin-e-veliajt-thaci-dhe-komandantet-e-uck-se-qytetare-nderi-te-tiranes/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 17:04:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 16:54:02 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `28d9acc64b6afea7df60d2b96efc1440a77e5245606e53346dc861e6121aba69` |
| TEKSTI | `5ae3aed9e3c4ab582da03263cfd53698f1019f284db2552b3e8fa2294d21dd26` |
| PAMJA | `468f03e58d77c5d7f3cc4deb2177cb1d55ecc6f35146d00be86be8b8602c8dd2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a56a7be8f02618360ce3d441fde3fa74fb38c62352af12c8d9e6010a9aabccfd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `622c8162b2af4b3a4f32b10517ab558346d08e6b143a7ec62e7fa674754e4065` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a56a7be8f02618360ce3d441fde3fa74fb38c62352af12c8d9e6010a9aabccfd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Komisioni Artistik-Kulturor miraton propozimin e Veliajt: Thaçi dhe Komandantët e UÇK-së "Qytetarë Nderi" të Tiranës

Aktualitet

Publikuar: 27/09/2026



Komisioni Artistik-Kulturor i Bashkisë së Tiranës ka miratuar propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Erion Veliaj, për shpalljen "Qytetar Nderi" të Tiranës të katër ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Propozimi nga komisioni i titujve me kryetar, historianin Pëllumb Xhufi vjen në një moment të ndjeshëm për katër ish-drejtuesit e UÇK-së. Propozimi i Veliajt u miratua unanimisht.

Siç është shprehur Kryetari Veliaj: "Tirana nuk është vetëm kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë, por kryeqendra e shqiptarisë."

Pas miratimit nga Komisioni Artistik-Kulturor, propozimi vijon procedurat institucionale për shqyrtim nga Këshilli Bashkiak i Tiranës.

Motivacionet për drejtuesit e UÇK-së:

**Hashim Thaçi**

Për kontributin e çmuar në Luftën Çlirimtare të Kosovës, në përfaqësimin politik të saj dhe në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë e pavarësisë, me mbështetjen e vendosur të SHBA-së dhe partnerëve euroatlantikë. Për lidhjen e veçantë me Tiranën dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

**Kadri Veseli**

Për kontributin e çmuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe në

Me te lexuarat


33 vite drejtor / Petrit Tare fshehje pasurie e pastrim parash, 15 shtëpi në Tiranë, 250 mijë eur


Kush është Denis Luli, shënjestra e atentatit në Athinë dhe i dyshuari Klod Cara, histori droge d...


Emrat / Goditen disa grupe që shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, 38 në pranga, 14 në kërkim


Elvis Shkambi drejt burgimit të përjetshëm për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria fitoi...


"Na ndërpreu takimin dhe mallkoi banorët", Braçe reagon pas përplasjes me aktivisten

rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë e pavarësisë, me mbështetjen e vendosur të SHBA-së dhe partnerëve euroatlantikë. Për lidhjen e veçantë me Tiranën dhe përkushtimin ndaj afrimit e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

**Jakup Krasniqi**

Për kontributin e çmuar në Luftën Çlirimtare të Kosovës, në përfaqësimin politik të saj dhe në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë e pavarësisë, me mbështetjen e vendosur të SHBA-së dhe partnerëve euroatlantikë. Për lidhjen e tij të hershme me Tiranën, si një nga qendrat e mbështetjes politike e qytetare për Kosovën.

Rexhep Selimi

Për kontributin e çmuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë e pavarësisë, me mbështetjen e vendosur të SHBA-së dhe partnerëve euroatlantikë. Për lidhjen e veçantë me Tiranën, kryeqytetin që në ditët e luftës qëndroi pranë Kosovës dhe popullit të saj.

TAG: komsndantët e uçk | Qytetar nderi | Thaçi | Tiranë

## Të ngjashme



**Kosova i kërkon dorëheqjen, ministrja: S'kam bashkëpunuar me Hagën për dënimin e 4 ish-krerëve të UÇK-së**



**Vuçiç: Do të jap dorëheqjen të dielën, por do të flas me Putinin para përfundimit të mandatit**



**"Hapni sytë për të gjitha kontratat që nënshkruani me fuqitë e mëdha" – Vuçiç ankohet në OKB për sulmin e NATO-s ndaj Serbisë**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

Email: [email protected]
Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.